



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 6/8 prot

Datë 26.01.2024

V E N D I M

Nr. 97/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024 me

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Atom” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e mesipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të shoqërisë “Krijon” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mesipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me adresë: “Rruga e Dibrës”, Nr. 371, 1005, Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Atom” SHPK me NUIS L22203042N, me adresë: Rruga “Islam Alla”, Pallati 56, Kati 1, Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, me NUIS J61817047D, me adresë: Bulevardi “Zhan D'ark”, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Krijon” SHPK me NUIS K12023001A, me adresë: Farkë, “Rruga e Elbasanit”, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.10.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.202, nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 13.12.2023, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“KRIJON” SHPK	9,876,000 lekë, skualifikuar
“BNT Electronics” SHPK	10,501,000 lekë, kualifikuar
BOE “ATOM” SHPK & “FEDOS” SHPK	12,980,000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 27.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 03.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 06/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3723 e operatorit ekonomik “Atom” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023, me objekt “*Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, ankimuesi kërkon lënien të skualifikuar të shoqërisë “Krijon” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

[...] Mendojmë dhe kemi dyshime se oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK ka mangësi dhe nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit vecanërisht pikën 2.3.1 (dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme); 2.3.2 katalogë/broshura që vërtetojnë se mallrat e ofertuara plotësojnë specifikimet teknike të parashikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të DST; 2.3.3 certifikimet përkatëse të konformitetit për mallrat e ofertuara; 2.3.6.b) certifikimet ISO të prodhuesit për artikullin e kërkuar. Gjithashtu edhe oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, krahas arsyeve të skualifikimit të publikuar në formularin e njoftimit të fituesit, mendojmë dhe kemi dyshime se gjithashtu nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, vecanërisht pikat 2.3.1 (dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme).

I.Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1. të shtojcës 7 të DST, me pretendimet si vijon:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së

njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në dijeninë tonë, ne kemi dyshime që shoqëria “BNT Electronics” SHPK nuk ka kontrata/fatura shitje të ngjashme për kategorinë e artikujve të kësaj procedure:

2.2. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

30121100-4-Fotokopjuese, 30213100-6-Kompjuteraportativ, 33192200-4-Tavolina mjekësore, 38510000-3-Mikroskopë, 38516000-5-Mikroskopë drite monokular dhe/ose binokular;

Sikurse cilësohet në pikën 2.3.5

2.3.5. Operatori ekonomik për artikujt mjekësor duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës.

Kuptohet që artikujt 1 dhe 3 bëjnë pjesë në Kategorinë e pajisjeve mjekësore (për qëllime didaklike); ndërsa artikujt e tjerë janë pajisje kompjuterike.

Rrjedhimisht dhe kontratat e ngjashme duhet të jenë për këto dy lloj kategorish dhe në vlerat respektive.

Nisur nga përvoja jonë në fushën e furnizimit të pajisjeve mjekësore të ngjashme me mallrat objekt prokurimi prej disa vitesh me radhë, si dhe informacionet e publikuara në Buletinet e Njoftimeve Publike të botuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe ne faqen zyrtare të OPENCORPORATES, rezulton se kjo kompani nuk ka kryer furnizime të ngjashme me procedurën e mësipërme objekt ankimi dhe konkretisht me shitjen e: Mikroskopëve Binokulare dhe Trinokulare si dhe për Komplete mikroskopesh për mikroskopët (LAMA mikroskopi të parapërgatitura).

Nga verifikimi i këtyre informacioneve nuk ka rezulton se janë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit (artikujt 1, 2 dhe 3). Ndoshta kompania ka plotësuar vlerën e kërkuar për furnizime të mëparshme për pajisje kompjuterike, printer, fotokopje por jo për artikujt 1, 2 dhe 3.

II. Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.2. të shtojcës 7 të DST , me pretendimin si më poshtë vijon:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. **Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas**

modelit të deklaruar. (Katalogu duhet të ngarkohet në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit.

Nisur nga specifikimet të publikuara në shtojcën 5 të DST, të cilat janë tepër specifike, që përgjithësisht të orientojnë në prodhime unike, madje modele të posacme të një prodhuesi (Optika srl Itali), dhe në bazë të njohurive profesionale të inxhinierëve tanë mbi opsionet që qarkullojnë për këtë qëllim, ne kemi dyshime se cdo lloj nga opsionet e ofertuara kanë devijime nga specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5. Prandaj mendojmë se katalogu/broshuar/skeda teknike e dorëzuar në SPE ose nuk përfshin/ shfaq të gjitha specifikimet e kërkuara ose kanë devijime në specifikime (psh në dimensione, në ekran etj...).

III. Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.4. të shtojcës 7 të DST , me pretendimin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjet e kërkuara sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i produktit	Kompania prodhuese	Vendi i origjinës	Emërtimi i katalogut/broschurës së produktit	Numri i faqeve të cilat përfshijn specifikimet	Certifikimet përkatëse të produktit (Certifikatë konformiteti sipas direktivës CE / FDA ose ekuivalente)
1						
2						
Etj.						

Certifikimet përkatëse të produktit (Certifikatë konformiteti sipas direktivës CE / FDA ose ekuivalente) do të plotësohet për artikujt numër 1, 3, 4, 5, 6,

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.”

Kemi dyshime se kompania “BNT Electronics” SHPK nuk ka plotësuar të gjitha detajet e sakta si në tabelë, në lidhje me ofertën teknike. Ose edhe nëse certifikimet përkatëse të artikujve të ofertuara janë plotësuar saktësisht, AK nuk ka bërë verifikimet përkatëse për këto certifikime të vetëdeklaruara (gjatë fazës së vlerësimit); si përsa i përket vlefshmërisë së certifikatave të konformitetit CE/deklaratave të konformitetit CE (në varësi të klasifikimit të artikujve), trupave certifikues apo nëse qëllimi i këtyre certifikimeve/deklaratave mbulon /përfshin kategorinë e artikujve në fjalë (emërtimet/modelet e paraqitura në ofertën teknike ose në katalogjet e dorëzuara).

IV. Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.6. të shtojcës 7 të DST , me pretendimin si më poshtë vijon:

a) Operatori ekonomik për artikujt e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e

vlerësimin të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

b) Operatori ekonomik ofertues **për artikujt numër 1 dhe numër 3** duhet të paraqesë **vetëdeklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimin të dokumentacionit.

Kemi dyshime se kompania “BNT Electronics” SHPK nuk ka paraqitur vetëdeklaratë ose certifikatën përkatëse të prodhuesit për artikuj 1 dhe 3. Ose edhe nëse kjo vetëdeklaratë me nr. certifikate etj... është dorëzuar, ne dyshojmë se AK nuk ka bërë verifikimet përkatëse për këtë certifikatë ISO (gjatë fazës së vlerësimin); si përsa i përket vlefshmërisë së certifikatës ISO, trupit certifikues apo nëse qëllimi i certifikatës mbulon/përfshin kategorinë ku bëjnë pjesë këto artikuj.

B. Në lidhje me ofertën e dorëzuar nga OE “Krijon” SHPK, krahas arsyeve të publikuar në formularin e njoftimit të fituesit, mendojmë dhe kemi dyshime se gjithashtu nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, vecanërisht pikën 2.3.1 (dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme).

I. OE “Krijon” SHPK, mendojmë se nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1. të shtojcës 7 të DST, me pretendimet si vijon:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

c) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose

d) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në dijeninë tonë, ne kemi dyshime që shoqëria “Krijon” SHPK nuk ka kontrata/fatura shitje të ngjashme për kategorinë e artikujve të kësaj procedure:

2.2. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimiti (FPP):

30121100-4-Fotokopjuese, 30213100-6-Kompjuteraportativ, 33192200-4-Tavolina mjekësore, 38510000-3-Mikroskopë, 38516000-5-Mikroskopë drite monokular dhe/ose binokular;
Rrjedhimisht dhe kontratat e ngjashme duhet të jenë për këto dy lloj kategorish dhe në vlerat respektive.

Nisur nga përvoja jonë në fushën e furnizimit të pajisjeve mjekësore të ngjashme me mallrat objekt prokurimi prej disa vitesh me radhë, si dhe informacionet e publikuara në Buletinety e Njoftimeve Publike të botuara nga Agjencia e Prokurimiti Publik dhe ne faqen zyrtare të OPENCORPORATES, rezulton se kjo kompani nuk ka kryer furnizime të ngjashme me procedurën e mësipërme objekt ankimimi dhe konkretisht me shitjen e pajisjeve kompjuterike printer, fotokopje etj ...

Nga verifikimi i këtyre informacioneve nuk ka rezulton se janë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit (artikujt 1, 2 dhe 3). Ndoshta kompania ka plotësuar vlerën e kërkuar për furnizime të mëparshme për pajisje kompjuterike, printer, fotokopje por jo për artikujt 1, 2 dhe 3.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 06/2 date 04.01.2024, me kriteret që operatori ekonomik “Atom” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga shoqëria “BNT Electronics” SHPK dhe “Krijon” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 06 prot., datë 03.01.2024.

II.6. Duke qënë se nga autoritetit kontraktor nuk i është dërguar asnjë informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Atom” SHPK, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës, nëpërmjet shkresës nr. 06/3 prot., datë 16.01.2024 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Atom” SHPK”, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesave pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, iu kërkua autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion i hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Atom” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.7. Në datën 24.01.2024, janë protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 06/4 prot., dhe 06/5 prot., përkatësisht shkresat e autoritetit kontraktor 3058/48 prot., datë 22.01.2024 me objekt: “Vendim, dhe shkresa nr.3058/49 prot., datë 23.01.2024 me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

Referuar shkresave të sipërcituara rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “Atom” SHPK. Konkretisht janë pranuar pretendimet e ankimuesit si vijon:

II. Për sa i përket argumentit të OE ankimues lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. **Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas modelit të deklaruar.** (Katalogu duhet të ngarkohet në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SEP nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, KSHA konstaton se janë paraqitur katalogët për artikujt e kërkuar, ku specifikisht janë konstatuar:

1. Mikroskop binokular për studentët - Ofertuar modeli N-300M nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD

- Mikroskop binokular me fushë të ndriçuar për metoda observimi me ndriçim të transmetuar. **Plotësohet**
- Zmadhimi maksimal: të paktën 1000 X. **Plotësohet**
- Me kokë binokulare me pjerrësi 30° dhe rrotullim 360°. **Pjerrësi 30°, jo rrotullim 360°**
- Të ketë rregullim dioptrik në njerin nga okularet. **Nuk ka.**
- Okularet me zmadhim 10 X me numer fushe jo më pak se 18mm. **Plotësohet.**
- Okularet të kënaqësive shikimi të lartë në mënyrë që të përdoren nga personat me syze optike. **Nuk plotësohet/specifikohet.**
- Të ketë mbajtëse të objektivave me të paktën 4 pozicione të rrotullueshme nga të dy drejtimet. **Nuk plotësohet.**
- Të furnizohet me objektive planare 4X, 10X, 40X, 100X me trajtim antifungal. **Plotësohet pjesë e parë, nuk ka trajtim antifungal.**
- Tavoline mekanike me mbajtëse mostre, me permasa të paktën 120mm x 110mm me shkallë Vernier me saktësi 0.1 mm. **Përmasat e tavolinës 140mm x 140mm/ 75 x 75 mm.**
- Diapazoni i levizjes së tavolines së punës: të paktën 70x30 mm. **Nuk plotësohet.**
- Kondensues Abbe me aperturë numerike 1.25 të fokusueshëm me rrotullim. **Nuk plotësohet.**
- Ndricimi LED me fuqi 3Ë – 6Ë dhe temperaturë ngjyre të paktën 6300 K. **Nuk plotësohet.**
- Jetegjatesia e llampes: jo më pak se 60000 ore punë. **Nuk plotësohet.**
- Mekanizëm fokusimi koaksial i trashë dhe i imët me ndalesë limit për të parandaluar kontaktin midis objektivit dhe mostrës.
- Rezolucioni i fokusimit: ≤ 0.004 mm. **Nuk plotësohet.**
- Tension i rregullueshëm i rrotullës të fokusimit të ashper. **Nuk plotësohet.**

- Te perfshihet me mikroskopin: Mbulesë për pluhurat dhe vaj imersioni. **Nuk plotësohet.**
- 2. a. Mikroskop trinokular - Ofertuar modeli NE700-E nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD**
- Me fushë të ndriçuar për metode observimi me dritë të transmetuar. **Plotësohet.**
 - Portë trinokulare për kamera me shpërndarje dritë 50/50. **Plotësohet.**
 - Tub siedentopf me perkulje 30° me kompensim dioptrik në okularin e majtë. **Plotësohet.**
 - Diametri i tubit jo me pak se 28 mm. **Plotësohet.**
 - Distanca interpupulare të pakten në diapazonin: 50-75mm. **47-78mm.**
 - Te ketë okular planar me zmadhim 10X dhe me numër fushë jo me pak 22 mm. **Plotësohet.**
 - Okularet të këne pike shikimi të lartë në mënyrë që të përdoren nga personat me syze optike dhe kapuç gome. **Nuk plotësohet/specifikohet**
 - Tavolinë e punës minimalisht 230 X145 mm, me shkallë vernier me saktësi 0.1 mm. **235 X150 mm**
 - Levizja e tavolines së punës të pakten: 75 X 52 mm. **78 X 54 mm**
 - Te ketë të përfshirë mbajtësen e mostres. **Plotësohet**
 - Mekanizmi i fokusimit koaksial i trashë dhe i imet me shkallëzim 0.002mm. **0.001 mm.**
 - Te ketë 5 pozicione për vendosjen e objektivëve të rotullueshëm në të dy drejtimet. **Nuk plotësohet/ specifikohet objektivët e rrotullueshëm në të dy drejtimet.**
 - Te shoqërohet me objektivë 4X, 10X, 40X, 100X planar me sistem optik me korrigjim në infinit. **Nuk plotësohet/specifikohet infinit.**
 - Distanca parfokale të pakten 45mm. **Nuk plotësohet/specifikohet**
 - Te sigurojë fushë të sheshtë deri në F.N 22. **Nuk plotësohet**
 - Sistem ndricimi Kohler i plote. **Plotësohet.**
 - Ndricimi LED me fuqi 3Ë – 6Ë dhe temperaturë ngjyrë të pakten 6300 K. **Plotësohet fuqia e ndricimit, por jo temperatura e ngjyrës.**
 - Jetëgjatësia e llampes të pakten 60000 ore punës. **Nuk plotësohet.**
 - Te ketë Kondensues tip sëing -out me N.A. 0.2/0.9 i cili të ketë mundësi të hiqet. **Plotësohet.**
 - Kondensuesi të ketë sistem qëndërimi dhe diafragë iris. **Plotësohet.**
 - Te perfshihet me sistemin: vaji i imersionit, mbulesa e pluhurave, Kompjuter i kompletuar me monitor, kamera për mikroskop, program profesional për përpunimin e imazhit të mikroskopit. **Nuk plotësohet/specifikohet**
- 3. Kamer mikroskop - Ofertuar modeli HDCE-X20 nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD**
- Te shoqërohet me kamera me ngjyra me rezolucion jo me të vogël se 20MP. **Plotësohet.**
 - Numri i pikselave jo me pak se 5440 X 3648. **Nuk plotësohet/specifikohet për këtë lloj kamere. Ndërkohë për 15@5440x3648, dhe për 50@2736x1824**
 - Permasat e pikselave: 2.4 X 2.4 um. **Plotësohet.**

- *Teknologjia e sensorit: CMOS. Plotësohet.*
- *Shpejtësia e imazhit (fps):*
- *Jo me e vogël se 15 në rezolucion maksimal. Plotësohet 17 frames për 21M Rezolucion*
- *Jo me e vogël se 60 në 1824 X1216 Nuk plotësohet/specifikohet*
- *Diapazoni i filtrit IR të pakten nga 380-650 nm. Nuk plotësohet/specifikohet*
- *Me dalje USB3.0. Plotësohet.*
- *Te ketë C-mount për lidhjen me mikroskopin. Plotësohet.*
- *Te shoqërohet me softëware për manipulimin e imazhit në kompjuter. Plotësohet.*

4. Tavolina mikroskopi për studentë (për 1 klasë laboratorike)- Ofertuar modeli ‘tavolina pune’ nga kompania Mobileri Oltjon Disha:

1. *Syprina e tavolinave të jetë me shtresë mbrojtëse ndaj lëndëve laboratorike gërryese, lagështirës dhe temperatures.*
2. *Në trupin ballor të çdo tavoline të jenë të montuar nga 3 prizat për sigurimin e burimit të energjisë për mikroskopët (3 mikroskopë në çdo tavolinë).*

Për këtë artikull nuk është paraqitur broshurë/katalog origjinal nga prodhuesi apo firmë, vukë dhe të dhënat e këtij të fundit, por është dorëzuar vetëm ilustrimi i kërkuar nga AK në DST.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron. III. Për sa i përket argumentit të OE ankimes lidhur me skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.4. të shtojcës 7 të DST, nga shqyrtimi i ofertës teknike të paraqitur nga ky ioperator rezulton se ka shënuar vetëm fjalën “CE” për artikujt 1,3, 4, 5, 6 pa shënuar as numër/datë certifikate apo direktivë/standard që plotësojnë pajisjet. Gjithashtu në SPE nuk është dorëzuar asnjë certifikatë konformiteti CE/deklaratë të konformitetit CE në varësi të klasifikimit të artikujve) për artikujt e kërkuar.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me mosplotësimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit, vecanërisht pikën 2.3.1 (dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme) të OE “Krijon” SHPK, ku mendojmë se nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1 të shtojcës 7 të DST, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “KRIJON” shpk rezulton se kjo kompani ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën 40.737.240 lekë pa tvsh, me objekt: “Blerje pajisje laborator për Dep.e Biologjisë” dhe Lot 2 :Blerje pajisje laborator për Dep.e bioteknologjisë”; “Ngritja e laboratorit të analizave të materialeve dhe teknologjive në arkeologji dhe trashëgimi kulturore”; “Blerje pajisje laboratorike për Universitetin Bujqësor të Tiranës”.

Po asnjë nga këto kontrata nuk përfshin të gjitha kodet e kësaj procedure. Konkretisht mungojnë : 30121100-4-Fotokopjuese, 30213100-6-Kompjuterat portativ, 33192200-4-Tavolina mjekësore.

Sa më sipër kontratat e paraqitura nga “Krijon” SHPK nuk konsiderohen si furnizime të ngjashme dhe ato nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron.”

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ATOM” SHPK për shoqërinë “BNT Electronics” SHPK dhe “Krijon” SHPK si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Njëpërmjet shkresave të autoritetit kontraktor 3058/48 prot., datë 22.01.2024 prot., me objekt: “Vendim, dhe shkresa nr.3058/49 prot., datë 23.01.2024 me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës”, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Vendimin me datë 22.1.2024 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ATOM” SHPK si vijon:

II. Për sa i përket argumentit të OE ankimues lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas modelit të deklaruar. (Katalogu duhet të ngarkohet në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike njëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SEP nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, KSHA konstaton se janë paraqitur katalogët për artikujt e kërkuar, ku specifikisht janë konstatuar:

5. Mikroskop binokular për studentët - Ofertuar modeli N-300M nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD

- Mikroskop binokular me fushë të ndriçuar për metoda observimi me ndriçim të transmetuar. **Plotësohet**
- Zmadhimi maksimal: të paktën 1000 X. **Plotësohet**
- Me kokë binokulare me pjerrësi 30° dhe rrotullim 360°. **Pjerrësi 30°, jo rrotullim 360°**
- Të ketë rregullim dioptrik në njerin nga okularet. **Nuk ka.**
- Okularet me zmadhim 10 X me numer fushe jo më pak se 18mm. **Plotësohet.**
- Okularet të këna pike shikimi të lartë në mënyrë që të perdoren nga personat me syze optike. **Nuk plotësohet/specifikohet.**

- Te kete mbajtese te objektivave me te pakten 4 pozicione e rrotullueshme nga te dy drejtimet. *Nuk plotësohet.*
 - Te furnizohet me objektive planar 4X, 10X, 40X, 100X me trajtim antifungal. *Plotësohet pjesa e parë, nuk ka trajtim antifungal.*
 - Tavoline mekanike me mbajtese mostre, me permasa te pakten 120mm x 110mm me shkalle Vernier me saktesi 0.1 mm. *Përmasat e tavolinës 140mm x 140mm/ 75 x 75 mm.*
 - Diapazoni i levizjes i tavolines se punes: te pakten 70x30 mm. *Nuk plotësohet.*
 - Kondensues Abbe me aperture numerike 1.25 i fokususeshem me rrotullim. *Nuk plotësohet.*
 - Ndricimi LED me fuqi 3Ë – 6Ë dhe temperature ngjyre te pakten 6300 K. *Nuk plotësohet.*
 - Jetegjatesia e llampes: jo me pak se 60000 ore pune. *Nuk plotësohet.*
 - Mekanizëm fokusimi koaksial i trashe dhe i imët me ndalesë limit për të parandaluar kontaktin midis objektivit dhe mostrës.
 - Rezolucioni i fokusimit: ≤ 0.004 mm. *Nuk plotësohet.*
 - Tension i rregullueshëm i rrotulles të fokusimit të ashper. *Nuk plotësohet.*
 - Te perfshihet me mikroskopin: Mbulesa per pluhurat dhe vaj imersioni. *Nuk plotësohet.*
- 6. a. Mikroskop trinokular - Ofertuar modeli NE700-E nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD**
- Me fushe te ndriçuar per metode observimi me drite te transmetuar. *Plotësohet.*
 - Porte trinokulare per kamera me shperndarje drite 50/50. *Plotësohet.*
 - Tub siedentopf me perkulje 30° me kompensim dioptrik ne okularin e majte. *Plotësohet.*
 - Diametri i tubit jo me pak se 28 mm. *Plotësohet.*
 - Distanca interpupulare te pakten ne diapazonin: 50-75mm. *47-78mm.*
 - Te kete okular planar me zmadhim 10X dhe me numer fushe jo me pak 22 mm. *Plotësohet.*
 - Okularet te kene pike shikimi te larte ne menyre qe te perdoren nga personat me syze optike dhe kapuç gome. *Nuk plotësohet/specifikohet*
 - Tavoline pune minimalisht 230 X145 mm, me shkalle vernier me saktesi 0.1 mm. *235 X150 mm*
 - Levizja e tavolines se pune te pakten: 75 X 52 mm. *78 X 54 mm*
 - Te kete te perfshire mbajtesen e mostres. *Plotësohet*
 - Mekanizmi i fokusimit koaksial i trashe dhe i imet me shkallezim 0.002mm. *0.001 mm.*
 - Te kete 5 pozicione per vendosjen e objektivave e rotullueshme ne te dy drejtimet. *Nuk plotësohet/ specifikohet objektivët e rrotullueshëm në të dy drejtimet.*
 - Te shoqerohet me objektive 4X, 10X, 40X, 100X planar me sistem optik me korigjim ne infinit. *Nuk plotësohet/specifikohet infinit.*
 - Distanca parfokale te pakten 45mm. *Nuk plotësohet/specifikohet*
 - Te siguroje fushe te sheshte deri ne F.N 22. *Nuk plotësohet*

- Sistem ndricimi Kohler i plote. **Plotësohet.**
- Ndricimi LED me fuqi 3Ë – 6Ë dhe temperature ngjyre te pakten 6300 K. **Plotësohet fuqia e ndricimit, por jo temperatura e ngjyrës.**
- Jetegjatesia e llampes te pakten 60000 ore pune. **Nuk plotësohet.**
- Te kete Kondensues tip sëing -out me N.A. 0.2/0.9 i cili te kete mundesi te hiqet. **Plotësohet.**
- Kondensuesi te kete sistem qenderzimi dhe diafragem irisi. **Plotësohet.**
- Te perfshihet me systemin: vaji i imersionit, mbulesa e pluhurave, Kompjuter i kompletuar me monitor, kamera per mikroskop, program profesional per perpunimin e imazhit te mikroskopit. **Nuk plotësohet/specifikohet**

7. Kamer mikroskop - Ofertuar modeli HDCE-X20 nga kompania Ningbo Yongxin Optics CO.LTD

- Te shoqerohet me kamera me ngjyra me rezolucion jo me te vogel se 20MP. **Plotësohet.**
- Numri i pikselave jo me pak se 5440 X 3648. **Nuk plotësohet/specifikohet për këtë lloj kamere. Ndërkohë për 15@5440x3648, dhe për 50@2736x1824**
- Permasat e pikselave: 2.4 X 2.4 um. **Plotësohet.**
- Teknologjia e sensorit: CMOS. **Plotësohet.**
- Shpejtesia e imazhit (fps):
- jo me e vogel se 15 ne rezolucion maksimal. **Plotësohet 17 frames për 21M Rezolucion**
- Jo me e vogel se 60 ne 1824 X1216 **Nuk plotësohet/specifikohet**
- Diapazoni i filtrit IR te pakten nga 380-650 nm. **Nuk plotësohet/specifikohet**
- Me dalje USB3.0. **Plotësohet.**
- Te kete C-mount per lidhjen me mikroskopin. **Plotësohet.**
- Te shoqerohet me softëare per manipulimin e imazhit ne kompjuter. **Plotësohet.**

8. Tavolina mikroskopi për studentë (për 1 klasë laboratorike)- Ofertuar modeli ‘tavolina pune’ nga kompania Mobileri Oltjon Disha:

1. Syprina e tavolinave të jetë me shtresë mbrojtëse ndaj lëndëve laboratorike gërryese, lagështirës dhe temperatures.
2. Në trupin ballor të çdo tavoline të jenë të montuar nga 3 priza për sigurimin e burimit të energjisë për mikroskopët (3 mikroskopë në çdo tavolinë).

Për këtë artikull nuk është paraqitur broshurë/katalog origjinal nga prodhuesi apo firmë, vulë dhe të dhënat e këtij të fundit, por është dorëzuar vetëm ilustrimi i kërkuar nga AK në DST.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron.

III. Për sa i përket argumentit të OE ankimes lidhur me skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.4. të shtojcës 7 të DST, nga shqyrtimi i ofertës teknike të paraqitur nga ky operator rezulton se ka shënuar vetëm fjalën “CE” për artikujt 1,3, 4, 5, 6 pa shënuar as numër/datë certifikate apo direktivë/standard që plotësojnë pajisjet. Gjithashtu në SPE nuk është dorëzuar asnjë certifikatë konformiteti CE/ deklaratë të konformitetit CE 9 në varësi të klasifikimit të artikujve) për artikujt e kërkuar.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron.

Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me mosplotësimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit, vecanërisht pikën 2.3.1 (dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme) të OE “Krijon” SHPK, ku mendojmë se nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1 të shtojcës 7 të DST, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “KRIJON” shpk rezulton se kjo kompani ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën 40.737.240 lekë pa tvsh , me objekt: “Blerje pajisje laboratorit për Dep.e Biologjisë” dhe Lot 2 :Blerje pajisje laboratorit për Dep.e bioteknologjisë”; “Ngritja e laboratorit të analizave të materialeve dhe teknologjive në arkeologji dhe trashëgimi kulturore”; “Blerje pajisje laboratorike për Universitetin Bujqësor të Tiranës”.

Po asnjë nga këto kontrata nuk përfshin të gjitha kodet e kësaj procedure. Konkretisht mungojnë : 30121100-4-Fotokopjuese, 30213100-6-Kompjutera portativ, 33192200-4-Tavolina mjekësore.

Sa më sipër kontratat e paraqitura nga “Krijon” SHPK nuk konsiderohen si furnizime të ngjashme dhe ato nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji.

Për sa më sipër [...] KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë qëndron.

Bazuar sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Vendosi:

- 1. Pranimin e pjesshëm të Ankesës së operatorit ekonomik “ATOM” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-82613-10-06-2023, me objekt: “Pajisje kompjuterike (Laptop, Desktop, UPS, Fotokopje, Printer, Projektor)”.*
- 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik sipas parashikimeve ligjore.*
- 3. Kopje e këtij Vendimi i dërgohet Komisioni të Prokurimit Publik, ankuesit dhe operatorëve ekonomikë të tjerë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit*

III.1.2. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ATOM” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023, me objekt “Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës .

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Atom” SHPK se: *“I.Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.1. të shtojcës 7 të DST, me pretendimet si vijon:*

- 2.3.3.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

- e) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose*
- f) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në dijeninë tonë, ne kemi dyshime që shoqëria “BNT Electronics” SHPK nuk ka kontrata/fatura shitje të ngjashme për kategorinë e artikujve të kësaj procedure:

2.2. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

30121100-4-Fotokopjuese, 30213100-6-Kompjuteraportativ, 33192200-4-Tavolina mjekësore, 38510000-3-Mikroskopë, 38516000-5-Mikroskopë drite monokular dhe/ose binokular;

Sikurse cilësohet në pikën 2.3.5

2.3.6. Operatori ekonomik për artikujt mjekësor duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës.

Kuptohet që artikujt 1 dhe 3 bëjnë pjesë në Kategorinë e pajisjeve mjekësore (për qëllime didaklike); ndërsa artikujt e tjerë janë pajisje kompjuterike.

Rrjedhimisht dhe kontratat e ngjashme duhet të jenë për këto dy lloj kategorish dhe në vlerat respektive.

Nisur nga përvoja jonë në fushën e furnizimit të pajisjeve mjekësore të ngjashme me mallrat objekt prokurimi prej disa vitesh me radhë, si dhe informacionet e publikuara në Buletinet e Njoftimeve Publike të botuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe ne faqen zyrtare të OPENCORPORATES, rezulton se kjo kompani nuk ka kryer furnizime të ngjashme me procedurën e mësipërme objekt ankimi dhe konkretisht me shitjen e: Mikroskopëve Binokulare dhe Trinokulare si dhe për Komplete mikroskopreparatesh për mikroskopët (LAMA mikroskopi të parapërgatitura).

Nga verifikimi i këtyre informacioneve nuk ka rezulton se janë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit (artikujt 1, 2 dhe 3). Ndoshta kompania ka plotësuar vlerën e kërkuar për furnizime të mëparshme për pajisje kompjuterike, printer, fotokopje por jo për artikujt 1, 2 dhe 3.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1. e dokumentavetë tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.2.2. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit të mësipërm të publikuara në SPE, rezulton se është parashikuar si vijon:

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia Totale
1.	Mikroskop binokular për studentë	100
2.	Komplete mikropreparatesh për mikroskopët (Lama mikroskopi)	50
3.	Mikroskop trinokular profesional për citologji, kompletuar me kamera imazhi video, fotografimi për mikroskop, softëare përpunimi imazhi, PC me monitor dhe printer lazer me ngjyra	4
4.	Videoprojektor	4
5.	Fotokopje profesionale me printim dhe qepje	1
6.	Laptope	7
7.	Tavolina mikroskopi për studentë (për 1 klasë laboratorike)	20

Afatet e lëvrimit:

45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë nr. 3467/4 prot., datë 12.02.2021 lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive”, me çmim total 40.381.600 lekë pa TVSH bashkëlidhur së cilës janë faturat elektronike me zërat përkatës.
Vërtetim realizim kontrate nr. 25418/1 prot., datë 12.08.2022, nga Bashkia Tiranë.
- Fatura elektronike nr. 815/2022, datë 13.06.2022
- Fatura elektronike nr. 996/2022, datë 20.07.2022
- Fatura elektronike nr. 1029/2022, datë 01.08.2022

- Fatura elektronike nr.1377/2022, datë 19.10.2022
- Fatura elektronike nr. 2695/2021, datë 13.10.2021
- Fatura elektronike nr. 2828/2021, datë 08.11.2021
- Fatura elektronike nr. 2870/2021, datë 16.11.2021
- Fatura elektronike nr. 2879/2021, datë 18.11.2021
- Fatura elektronike nr. 1045/2022, datë 05.08.2022
- Fatura elektronike nr. 2349/2021, datë 20.08.2021
- Fatura elektronike nr. 1038/2022, datë 04.08.2022

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për*

këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur

duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronic” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

KPP konstaton, se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të sipërpërmendur, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, *operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara* Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “BNT Electronic” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Kontratë nr. 3467/4 prot., datë 12.02.2021, lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive”, me çmim total 40.381.600 lekë pa

TVSH, bashkëlidhur së cilës janë faturat elektronike me zërat përkatës, si dhe vërtetimin realizimin me sukses të kësaj kontrate me nr. 25418/1 prot., datë 12.08.2022, nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu, ka paraqitur 11 fatura elektronike të realizuar me sektorin privat, ku rezultojnë të dhënat mbi datat, shumat dhe furnizimet/shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre, si dhe përshkrimi i mallit të faturave elektronike rezulton, se ato janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Konkretisht kontrata me objekt: “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive”, me çmim total 40.381.600 lekë pa TVSH, zërat e saj konsiderohen të ngjashëm me objektin e prokurimit për zërat videoprojektor, fotokopje dhe laptop. Gjithashtu, zërat në faturat elektronike të paraqitura në ofertën e subjektit “BNT Electronics” SHPK si më sipër cituar, konsiderohen të ngjashme me zërat mikroskop të parashikuara në DT. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon, se ka realizuar eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe ka plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontrata dhe faturat elektronike të paraqitura janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Atom” SHPK se: “**IV. Kërkojmë skualifikimin e kompanisë “BNT Electronics” SHPK pasi nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të pikës 2.3.6. të shtojcës 7 të DST , me pretendimin si më poshtë vijon:**

a) *Operatori ekonomik për artikujt e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).*

b) *Operatori ekonomik ofertues **për artikujt numër 1 dhe numër 3** duhet të paraqesë **vetëdeklaratë** për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Kemi dyshime se kompania “BNT Electronics” SHPK nuk ka paraqitur vetëdeklaratë ose certifikatën përkatëse të prodhuesit për artikuj 1 dhe 3. Ose edhe nëse kjo vetëdeklaratë me nr. certifikate etj... është dorëzuar, ne dyshojmë se AK nuk ka bërë verifikimet përkatëse për këtë certifikatë ISO (gjatë fazës së vlerësimit); si përsa i përket vlefshmërisë së certifikatës ISO,

trupit certifikues apo nëse qëllimi i certifikatës mbulon/përfshin kategorinë ku bëjnë pjesë këto artikuj”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6 e dokumentave të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.6 a) *Operatori ekonomik për artikujt e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).*

*b) Operatori ekonomik ofertues **për artikujt numër 1 dhe numër 3** duhet të paraqesë vetëdeklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

III.3.2. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, për sa i përket artikujve numër 1 dhe numër 3, rezulton së është paraqitur deklaratë ku thuhet shprehimisht si vijon:

“Ne kuader te procedures se siperpermendur dhe plotesimit te Kushteve te Vecanta te Kualifikimit, specifikisht pikave 2.3.6 (b), BNT Electronics shpk, deklarom si me poshte: Shoqeria BNT Electronics shpk, deklarom per artikujt numër 1 dhe numër 3 se prodhuesi i ketyre pajisjeve eshte i certifikuar ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata eshte e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.”

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*
- b) efikasitetit të energjisë;*
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.3.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt - prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garantitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet deklaratës së sipërcituar. Nga shqyrtimi i materialeve të depozituara për shqyrtimin e ankesës, rezulton, se në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, për artikujt 1 dhe 2, operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK ka paraqitur vetëdeklarim, në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor, të parashikuar në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit si më sipër cituar. Nga ana tjetër, referuar përgjigjes së KSHA-së, në vendimin për trajtimin e ankesës së ankimuesit rezulton, se kjo e fundit nuk ka pranuar pretendimet e ankimuesit me argumentet si vijon: *“KSHA nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga “BNT Electronics” SHPK në SPE, rezulton se kjo kompani ka paraqitur vetëdeklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me formën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në DST. Sa më sipër [...] pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”*

Pra, lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“nëse kjo vetëdeklaratë me nr. certifikate etj... është dorëzuar, ne dyshojmë se AK nuk ka bërë verifikimet përkatëse për këtë certifikatë ISO (gjatë fazës së vlerësimit); si për sa i përket vlefshmërisë së certifikatës ISO, trupit certifikues apo nëse qëllimi i certifikatës mbulon/përfshin kategorinë ku bëjnë pjesë këto artikuj”,* rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është bërë asnjë verifikim konkret për vetëdeklarimin e shoqërisë “BNT Electronics” SHPK për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, për artikujt 1 dhe 2, në kundërshtim me parashikimin e bërë në dokumentet e tenderit sipas të cilit: *“**Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.**”*

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur të operatorit ekonomik “Atom” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023 me objekt “Digjitalizimi i Njesisë Laboratorike të Histologjisë”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Atom” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Atom” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

